



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr. prot

Tiranë, më 07.04.2011

**V E N D I M
Nr. 185, Datë 07.04. 2011**

**“ Për
marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e
prodhimit dhe të tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”**

Objekt: Mbi marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prodhimit dhe të tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës midis ndermarrjeve që operojnë në këto treg.

Baza ligjore: Nenet 4, pika 1, 24, germa d, 44, pika 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, këtu dhe me poshtë Ligji.

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij të datës 07.04.2011, pasi shqyrtoi relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Raportin e Grupit të Punës për monitorimin e tregut përkatës të prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës:

K O N S T A T O I :

Nga raportet e medias të datës 25 Mars 2011 është informuar se ka një rritje të menjëhershme dhe thujse nga të gjithë ofruesit të çmimit të bukës në qytetin e Vlorës.

Nga monitorimi i realizuar nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës në bazë të nenit 28, germa a të Ligjit, u konstatua se rritja e çmimit të bukës në qytetin e Vlorës ka ardhur në mënyrë të menjëhershme pas një mbledhje të 42 prodhuesve dhe tregtuesve të bukës, ku është rënë dakord se që nga data 23.03.2011 çmimi i bukës 900 gr do të jetë 120 lek dhe çmimi i bukës 450 gr do të jetë 60 lek.

Nga procesverbalet e mbajtura nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës të firmosur nga disa prej prodhuesve dhe tregtuesve të bukës në qytetin e Vlorës, rezulton se në mbledhje është rënë dakord që: **“Shoqata e furrave të bukës Vlorë vendosi në datën 21.03.2011 që buka në datën 23.03.2011 të ketë çmimin 900 gr = 120 lek dhe 450 gr = 60 lek’.**

Ky dokument është afishuar në të gjitha njësitet tregtare dhe prodhuese të bukës dhe çmimi i fiksuar nga inspektimet e kryera rezulton se është zbatuar nga të gjithë pjesëmarrësit në mbledhjen e datës 21.3.2011, sipas procesverbalit të administruar.

Sjellja e këtyre ndërmarrjeve për fiksimin e çmimit të shitjes së bukës në qytetin e Vlorës ka të ngjarë të jetë një shkelje e nenit 4, pika 1, germa a) të Ligjit Nr 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar.

Kjo shkelje e mundshme sjell një dëm të rëndë për konkurrencën në treg, dhe për konsumatorët.

PËR KËTO ARSYE :

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të neneve 24, shkronja d, 44, pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”i ndryshuar, për shkak të dëmit që mund t’i shkaktohet konsumatorëve të qytetit të Vlorës nga sjellja anti-konkurrese e 42 prodhuesve dhe tregtuesve të bukës, dhe meqenëse ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 4 të Ligjit,

V E N D O S I:

- I. Marrjen e masave të përkohshme sipas nenit 44, pika 1, si vijon:
 - Pjesëmarrësit në marrëveshjen e ndaluar për rritjen dhe fiksimin e çmimit të bukës në qytetin e Vlorës, duhet t’i japin fund menjëherë sjelljes së bashkërenduar për fiksimin e çmimit të bukës.
- II. Masat e përkohshme duhet të zbatohen me marrjen në dijeni të këtij vendimi.
- III. Këto masa të përkohshme do të zbatohen për një periudhë kohe deri në perfundim të hetimit.

- IV. Moszbatimi i vendimit për masa të përkohshme, i cituar në pikën 1 të këtij vendimi, ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b të Ligjit
- V. Në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, në bazë të nenit 76, pika b të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës mund të vendosë gjoba periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore të vitin financiar para-ardhës, e cila llogaritet nga data e marrjes së këtij vendimi.
- VI. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për komunikimin e vendimit të gjithë pjesëmarrësve në marrëveshje dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Rezana KONOMI	Koço BROKA
(_____)	(_____)	(_____)
Anëtar	Anëtar	Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R